

Në vijim, do të prezentohen dhe sqarohen metodat e rëndësishme që i përshtaten punës në grupe. Në pjesën më të madhe të gjitha këto metoda nxisin mësimin e pavarur dhe kompetencën e të vepruarit nga ana e nxënësve. Gjatë punës në grupe, çdo mësimdhënës përcjell qëllimet në vijim:

Qëllimet e punës në grupe

- Nxitja e pavarësisë dhe aftësisë individuale të mësimit tek secili nxënës
- Ushtrimi dhe aplikimi i aftësive dhe metodave të ndryshme të punës
- Nxitja e kooperimit dhe bashkëpunimit



Puna në grupe kërkon shumë kohë, por është shumë e përshtatshme për përsëritje, për aplikim të njohurive, shkathtësive si dhe për krijimin e mendimit. Në praktikë grupet prej 3-5 pjesëmarrësve janë treguar të suksesshme. Grupet mund të shtjellojnë detyrën e njëjtë apo mësimdhënësi bënë ndarjen e detyrave prej një teme komplekse. Pika më e rëndësishme gjatë punës në grupe është definimi i qartë i qëllimit.

Në metodat kreative të punës në grupe që pasojnë më poshtë, para së gjithash do të sqarohet roli i ri, si këshilltar dhe moderator, i mësimdhënësit.



Metoda me projekte


Në qendër të metodës me projekte është prodhimi i një gjësendi kuptimplotë dhe të përdorshëm apo zhvillimi praktik i ndonjë procesi të punës. Propozimi për projekt mund të vie edhe nga ana e nxënësve. Në kuadër të një grupi, nxënësit pavarësisht planifikojnë dhe zbatojnë ndonjë projekt.

Puna në projekt mund të zgjasë disa ditë, javë apo edhe disa muaj dhe për nxënësit paraqet kërkesa sociale dhe profesionale. Mësimdhënësi përcjellë projektin dhe ndërhyr vetëm në rast të ndonjë problemi që nxënësit nuk mund ta zgjedhin.

Përveç kërkesave të lartpërmendura, një projekt duhet të plotësoj edhe këto kriteret:

Kriteret e projektit

- Duhet të posedohen shumë aftësi parciale të mësuara
- Ndërlidhshmëri e mirë mes njohurive dhe aftësive
- Duhet prekur të gjitha pjesët mësimore (psikomotorik, kognitiv dhe afektiv)
- Nxënësit duhet ti lihet shumë hapsirë për planifikim, zbatim dhe kontroll të pavarur.



Përdorimi i metodës me projekte mund të jetë një plotësim shumë i mirë kah fundi i shkollimit profesional. Mirëpo gjithmonë duhet pasur parasysh kriteret kohore dhe organizative lidhur me këtë metodë.

Projektet e realizuara janë pozitive sidomos në rast të zbatimit të tyre paraprakisht me punën e nxënësit. Planifikimi, zbatimi dhe kontrolli i pavarur nga ana e nxënësve duhet të bëhet si në vijim:

Hapat e punës me projekt

1. Dallimi dhe kuptimi i gjendjes fillestare
2. Planifikimi i veprimit
3. Të vendoset lidhur me ecurinë
4. Zbatimi i veprimeve
5. Kontrollimi i rezultateve
6. Vlerësimi i rezultateve të veprimit

Mind-Mapping

Fjala angleze „mind-map“ e përkthyer, qëndron për shpirtin, inspirimin, kujtesën, punën mendore - në kuptim bukfal „ Hartë e tokës së trurit“.

Mind-Mapping është një metodë kreative e mësimit dhe e punës, me të cilën njeriu mund të përpunojë probleme të ndryshme. Me anë të kësaj metode, para së gjithash aktivizohet edhe të menduarit foto-hapsinor. Kur ne konfrontohemi me ndonjë problem, truri ynë zhvillon zakonisht shumë ide, që nuk strukturohen dhe shpesh edhe humbin. Tek Mind-Mapping nisemi nga një temë, e cila shkrihet në mes të tabelës apo ndonjë flete dhe pastaj formohen degëzimet.



Në vazhdim barten aspekte të temës, të cilat lidhen me trungun në formë të degëve dhe degëzimeve. Aspektet kryesore paraqiten në formë të degës, ndërsa aspektet dytësore në formë të degëzimeve. Disa nga aspektet shënohen në formë të fjalës së shkurtër.

Të mos mendohemi gjatë. Në fillim nuk kërkohet logjika! Shkruani çdo gjë që ju bie ndërmend. Vlerësimi pason më vonë.



Mind-Mapp, në veçanti, përshtatet për shtjellimin e parë të një teme të re komplekse ose edhe për radhitjen e një tematike në një plan më të gjerë.

Tek kjo metodë vijnë në shprehje parimet didaktike: Prej së përgjithshmes kah e veçanta dhe prej abstraktes kah konkretja. (krahaso Kap. 9).

Përparësitë e Mind-Mapp


- Formë e hapur prezantuese
- Mendimeve u lihet „ecje“ e lirë
- Kreativitet pa kufinj të përcaktuar
- Çdo kohë mund të bëhen plotësime
- Një formë e kapshme për të gjithë

Brainstorming (Stuhi mendimesh)

Tek Brainstorming kemi të bëjmë me një mbledhje, të shkurtër, të kufizuar, të ideve, në mënyrë që të gjejmë zgjidhjen e ndonjë problemi, gjatë shkollimit. Gjithashtu përdoret edhe termi konferencë idesh. Para Brainstorming, nxënësit duhet njoftuar me rregullat dhe kohëzgjatjen (zakonisht 20-30min.). Nxënësit duhet të kenë kontakt me sy (p.sh. të ulen në gjysëm rreth).

Rregullat e Brainstorming -ut

- Të gjitha idetë duhet të formulohen në formë të fjalive të shkurtëra.
- Idetë shënohen, nga ana e mësimitdhënësit, në tabelë apo dërrasëz afis himi - Pinnwand.
- Sa më shumë shfaqje idesh, aq më mirë.
- Idetë e të tjerëve duhet ndërlidhur me idetë personale, për të arritur tek ndonjë ide e re.
- Ndalohet absolutisht çdo kritikë ndaj mendimeve të shprehura.



Në fazën vijuese, atë të vlerësimit, do bëhet vlerësimi i ideve të veçanta dhe do të shikohet mundësia e përdorimit të tyre. Tani, në këtë fazë mund të japim vërejtje në formë të kritikës.

Mundësisht, vlerësimi do të duhej të bëhej në fund të fazës kreative, dhe atë udhëhequr nga vetë grupi. Vetë grupi vendosë se cilat zgjidhje mund të vijnë në konsiderim e cilat jo. Zakonisht në bazë të kësaj do të përcaktohen edhe hapat parcialë të ardhshëm, për vendosjen e propozimeve për zgjidhje.

Ecuria e Brainstorming

1. Mësimitdhënësi motivon nxënësit që të shprehin mendimet e tyre lidhur me ndonjë problem kreativ
2. Nxënësit shprehin idetë e tyre, të cilat që të gjitha duhet notuar. Nuk guxon të bëhet vlerësimi apo kritika e ideve (të punohet me kohë të kufizuar)
3. Kontrollimi i përbashkët i ideve, mbi përdorimin e tyre


Metaplan

Teknika metaplan shikohet si një evoluim i mëtejshëm i Brainstorming. Në thelb ajo paraqet një metodë pyetëse me letra. Përkrah ideve të prezentuara dhe mundësive për zgjedhje, pason vizualizimi me anë të teknikës metaplan. Në shkollimin profesional, këto dy metoda mund të ndërlidhen mjaft mirë.

Për vizualizim shërben një tabelë e butë, e mbuluar me letër paketimi, një pllakë stiropori, apo një tabelë me magnet.

Ecuria e Teknikës metaplan

- Mendimet lidhur me temën e dhënë, shkruhen nga mësimmshënësi në letër (për çdo mendim nga një letër)
- Letrat vendosen në Pinnwand që të shihen, dhe bashkarisht kërkohen mundësitë për një strukturim
- Kur të gjitha letrat janë të vendosura, mundohemi të gjejmë mbititullimin për secilën ide dhe gjatë kësaj të bëjmë edhe korrigjimin e radhitjes së letrave.



Sidomos është kuptimplotë, përdorimi i teknikës metaplan, ndër të tjera, gjatë demonstrimit të rezultateve të punës. Disa anëtarë të grupit mund të ndërlidhin rezultatet e tyre, të paraqesin ndërlidhshmëritë e shkaktarit dhe të veprimt.

Teknika metaplan, për nxënësit githmonë ka ndikim nxitës dhe aktivizues.





Loja e roleve

Është një metodë pedagogjike për të ushtruar mënyrën e sjelljes dhe shërben për të mësuar mënyrën e sjelljes së një individi apo të një grupi. Pjesëmarrësit në lojën e roleve prezantojnë sjelljen gjatë një situatë që e kanë përjetuar. Me këtë rast mund të vjen deri tek zgjimi i emocioneve dhe mund të ushtrohen mënyra të tjera të sjelljes. Shikuesit nga anash mbajnë në mend mënyrën e sjelljes. Sidomos situatat konfliktuoze, janë të përshtatshme për një lloj të tillë.

Edhe ndonëse ndonjë situatë është luajtur, ajo mund të ketë një rëndësi të madhe pedagogjike, p.sh. problemet e përsëritura mund të sqarohen dhe të zgjidhen më mirë.

Pasi që loja e roleve në punën pedagogjike në Kosovë është mjaft e panjohur dhe shumë mësime të mëdha nuk kanë përvojë në përgatitjen e metodës së tillë, në vijim pasojnë disa informata mbi ecurinë e lojës së roleve:

Nivelet e lojës së roleve	Aktivitetet
Tema- dhe ndarja e roleve	Ju sqaroni se çka keni ndërmend dhe bëni ndarjen e roleve. Ndarja e roleve mund të bëhet p.sh. përmes paraqitjes vullnetare apo përmes tërheqjes së letrës. Pastaj secili lojtarë merr përshkrimin e rolit të tij ndërsa shikuesit marrin rolin e vrojtuesve.
Përgatitja e roleve	Lojtarit duhet lënë kohë e mjaftueshme për tu përgatitur për rolin e tij, në mënyrë që të mund të identifikohet me personin që e luan.
Faza e lojës	Tani fillon loja dhe vrojtuesit shënojnë rrjedhën e lojës si dhe sjelljen e lojtarëve.
Analiza	Tani urdhërohen shikuesit që të analizojnë sjelljet e vrojtuar duke mos lejuar diskutim.
Diskutimi	Tani të gjithë të pranishmit mund të prezantojnë përvojat dhe rezultatet e analizave të tyre. Diskutimi duhet të orientohet në drejtim të zhvillimit të lojës. Së pari u lejonet lojtarëve diskutimi. Duhet të potencojnë aspektet pozitive të lojës dhe sjelljen e aktorëve. Sidomos vrojtuesit duhet inkuadruar në vlerësimin e tyre dhe të përbahemi me vlerësimet tona.
Përmbledhja	Loja e roleve duhet të përfundohej me një përmbledhje, e cila ndërlidhet me detyrën e dhënë si dhe duhet potencuar sukseset e arritura.